SITUATA HIDROMETEOROLOGJIKE GJATË KËTYRE DITËVE (17-19.2021) DHE PARASHIKIMI

Data e parashikimit: Nr. 009/ 2021
E Hëne, 19 korrik 2021 – 12:00 (CET)
E vlefshme:
19 – 23/07/2021 00:00

Informim

Gjatë këtyre 3 ditëve, sipas stacioneve meteorologjike automatike, sasia më e lartë e reshjeve ka rënë gjatë datës 17/07/2021 (Kamenicë 39.9, Ferizaj 19.4, Podujevë 11.2 etj), ndërsa me datë 18/07/2021, sasia më e lartë e reshjeve është regjistruar në Malishevë 15.7, Prizren 13.1, Istog 12.5 etj. Kurse me datë 19/07/2021, Dragash 27.4 Prishtinë 24.0, Prizren 9.3 etj.
Gjatë stuhisë së datës 19/07/2021, e cila përfshiu një pjesë të Kosovës e sidomos Prishtinën, vetëm brenda 26 min. nga ora18:36 deri 19:02 kanë rënë 21.8 mm reshje (l/m^2), apo sa gjysma e mesatares shumëvjeçare e muajit korrikut për Prishtinë, ndërsa gjatë këtyre 3 ditëve, kanë rënë 39.6 mm.
Nga data 17 deri më 19.07.20210, sasia më e lartë e reshjeve është regjistruar në Dragash 59.6 mm pastaj në Kmenicë me 58.1 mm, Ferizaj 37.1, Junik 36.5 mm, Malishevë 29.5 mm, Podujevë (Shajkoc) 26.3 mm, Prizren 25.3 mm Istog 20.1 mm etj.

Sasia e reshjeve (mm), sipas stacioneve meteorologjike - online



Në bazë të këtyre të dhënave vërejmë që reshjet e këtyre ditëve nuk kanë pasur ndonjë shpërndarje të barabartë kohore dhe hapësinore në territorin e vendit ton, por ato ishin kryesisht në formë të rrebesheve të shiu të përcjellura me erëra të forta dhe shkarkime rrufesh, e në disa vende është regjistruar edhe breshër. Situatë gati se e ngjashme është edhe në vendet e tjera të rajonit

Gjendja e lumenjve është e qëndrueshme. Në të gjithë lumenjtë e vendit, nivelet kanë pësuar ngritje të lehët të cilat janë në kuotat e tyre normale dhe nuk paraqesin as një rrezik. Këto tendenca do të vazhdojnë të jenë deri ditën e mërkure datë 21/07/2021, kur pritet ndërprerje e reshjeve dhe fillimisht përmirësim i kushteve atmosferike e pastaj edhe i atyre hidrologjike.

Tabela 1. Gjenda e nivele nëpër lumenjtë kryesorë të Kosovës, sipas stacioneve hidrometrike online.

	LUMI	VENDI	18/07/2021 (H=Cm) 07:00	19/07/2021 (H=Cm) 07:00	Tendenca
1	Drini Bardhë	Gjonaj	1.68	1.70	+2
2	Drini Bardhë	Këpuz	0.85	0.94	+9
3	Ibri	Mitrovicë	0.46	0.42	-4
4	Ibri	Leposaviç	1.46	1.53	+7
5	Morava Binçës	Konçul	2.49	2.25	+24
6	Lepenci	Hani Elezit	0.76	0.78	+2
7	Bistrica Pejës	Grykë e Rugovës	0.60	0.62	+2
8	Sitnica	Nedakoc	1.80	1.92	+12

Parashikimi i motit për pesë ditë (19 – 23 korrik 2021)

Java fillon me kushte pothuaj të ngjashme meteorologjike me ditët e fundit.
Dita e hënë dhe e martë paraqiten me vranësira, riga shiu dhe shkarkime rrufesh. Nuk përjashtohen mundësitë që në territore të vogla rigat e shiut të shoqërohen me breshër.
Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 12-18 gradë Celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 25-28 gradë Celsius. Do të fryjë erë kryesisht nga verilindja e lehtë dhe lokalisht e fortë.
Kushtet agrometeorologjike paraqiten relativisht të mira përjashtuar fushatën e korrje shirjes, sepse këto reshje e kanë ndalur ketë proces i cili mund të vazhdoj sërish nga mesi i javës ku parashihen rreze dielli.
Sasitë e reshjeve të regjistruara në rrjetin e IHMK më të larta ishin në lindje dhe verilindje të territorit, ku sasia totale e reshjeve arriti rreth 50 litër për metër katrorë. Qendra e Kosovës shënoj 20-25 litër për metër katrorë. Verilindja 40-45 litër për metër katrorë, ndërsa në perëndim të vendit sasia totale e reshjeve u regjistrua nga 15-20 litër për metër katrorë.
Në disa zona të komunës së Skenderajt kishte edhe breshër, ku janë shënuar dëme në kulturën e grurit, misrit dhe në perimekulturë.
Në fundjavë parashihen rritje të temperaturave maksimale.

Situata të tilla hidrometeorologjike mund të shkaktojnë probleme dhe vështirësi lokale, si në funksionimin e sistemeve të kanalizimeve, dhe të ujërave atmosferike, vështirësi lokale të qarkullimit rrugorë, rrëshqitje të dheut, dëme në bujqësi, transportin e energjisë elektrike etj

Ky informacion do të përditësohet nga IHMK sipas, situatës dhe llogaritjeve meteorologjike dhe hidrologjike. Për më tepër, përcilleni ueb faqen tonë me të dhënat hidrometeorologjike, si dhe njoftimet e fundit:

http://ihmk-rks.net/

https://www.facebook.com/ihmk.rks/

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
Rruga "Lidhja e Pejës. Nr. 47
10000. Prishtinë

Tel: +383 038 60 384
http://ihmk-rks.net/
ihmk@rks-gov.net

Sektori i Hidrologjisë
bashkim.kastrati@rks-gov.net
Mob: +383 44 256552